

# KËSHILLA TË PËRKOZHSHME PËR KLIENTËT E KFN-SË PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E RREZIQEVE SHËNDETËSORE NGA COVID-19 NË VENDIN E PUNËS

Pandemia e COVID-19 është një tragjedi njerëzore që paraqet shumë sfida për punëdhënësit në nivel global, përfshirë edhe klientët e KFN-së, të cilët ofrojnë produkte dhe shërbime kyçe në shumë vende, si dhe vende pune dhe kushte jetese për punëtorët dhe familjet e tyre. Parandalimi i përhapjes së COVID-19 në vendin e punës dhe sigurimi i kushteve të sigurta për punë për ata që ende punojnë është me rëndësi thelbësore për të gjitha kompanitë dhe shoqërinë në përgjithësi.

## OBJEKTIVI

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti me Këshilla të Përkohshme është të jepet një përmbledhje dhe këshilla në dispozicion të publikut nga burime të njohura ndërkombëtarisht për t'u ndihmuar klientëve të KFN-së që t'i identifikojnë shpejt masat për parandalimin dhe menaxhimin e shpërthimeve të COVID-19 në vendin e punës dhe për përgjigje ndaj infeksionit me COVID-19 në komunitet. Burimet për këtë dokument - dhe informacion shtesë - janë në listë në Shtojcën 1.

Ky dokument nuk ka për qëllim të jetë shterues, dhe ofron këshilla të përgjithshme dhe jo specifike për sektorët. Kompanitë në sektorët me rrezik të lartë duhet t'i referohen procedurave dhe standardeve specifike për ata sektorë. Shihni shpjegimin e plotë të përgjegjësisë në fund të dokumentit.

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me dokumentet e mëposhtme të këshillave të KFN për COVID-19:

- Këshillë e Përkohshme për klientët e KFN-së për përkrahjen e punëtorëve në kontekstin e COVID-19, ku ofrohen këshilla se si t'i përkrahni punëtorët gjatë krizës së COVID-19 dhe si të merrni në konsideratë opsionet për rikthim.
- Këshillë e përkohshme për klientët e KFN-së për zhvillimin e një Plani të Përgatitjes dhe Reagimit në Emergjencë për COVID-19, i cili ka për qëllim t'u ndihmojë kompanive t'i identifikojnë rreziqet, ndajnë përgjegjësitë dhe të planifikojnë t'u përgjigjen në mënyrë efektive sfidave të lidhura me COVID-19.

## PARANDALIMI DHE REAGIMI

Çdo kompani këshillohet ta emërojë një ekip të dedikuar me përgjegjësi për të identifikuar dhe zbatuar veprimet që mund t'i zbutin efektet e COVID-19 në kompani dhe në komunitet. Çdo pjesë më poshtë sugjeron shembuj praktikë mbi veprimet që ndërmarra duhet t'i marrë.

### Jepni informacion mbi COVID-19<sup>(1, 3, 16, 20)</sup>

Rastet e mëparshme të përhapjes së sëmundjeve kanë treguar që shpërndarja e informacionit dhe trajnimi janë një mënyrë efektive për ta zvogëluar rrezikun si për kompani ashtu edhe për publikun e gjerë.

Kompania këshillohet të zhvillojë dhe të japë informacione mbi praktikën e mira për parandalimin e bartjes së COVID-19, veçanërisht duke respektuar rekomandimet për distancimin social, dhe për trajnimin e punonjësve që t'i njohin simptomat e COVID-19 dhe ta kuptojnë reagimin e kërkuar prej tyre, pas sugjerimeve të dhëna në këtë dokument.

## COVID-19 SIMPTOMAT E ZAKONSHME <sup>(11, 22)</sup>

Ethet, lodhja, vështirësi në frymëmarrje, kollat e thatë, rrëqethje, dridhje e përsëritur me rrëqethje, dhimbje muskuj, kokëdhimbje, dhimbje fyti, dhe humbje e re e shijes ose nuhatjes. Disa pacientë mund të kenë bllokim të hundës, rrjedhje të hundës, ose diarre. Simptomat mund të shfaqen nga dita e 2-të deri në ditën e 14-të pas ekspozimit ndaj virusit.

Kompania duhet t'i identifikojë pikat e fokusit dhe kanalet e komunikimit (për shembull, SMS dhe email) brenda kompanisë për t'i trajtuar shqetësimet e punëtorëve në mënyrë të vazhdueshme, dhe të sigurojë që kanalet e tilla të kenë resurset adekuate (për shembull, punonjës në punë 24-orë në linjën urgjente telefonike të përgjigjeve).

## Kërkoni nga punëtorët e sëmurë ose potencialisht të infektuar të rrinë në shtëpi ose të punojnë nga shtëpia.

<sup>(7, 16, 20)</sup>

Për të parandaluar që personeli potencialisht i infektuar të hyjë në vendin e punës dhe t'i infektojë kolegët, kompania duhet t'u kërkojë punëtorëve që të qëndrojnë larg punës në rastet kur shfaqin ndonjë simptomë të COVID-19 ose kanë qenë në kontakt të afërt me një pacient të konfirmuar me COVID-19 gjatë 14 ditëve të mëparshme.<sup>16</sup> Punëtorët që nuk ndjehen mirë duhet të kërkojnë menjëherë këshilla mjekësore. Punonjësi që punon gjatë kohës kur shfaq simptoma të buta të COVID-19 mund të rrezikojë përhapjen e kësaj sëmundjeje infektive te të tjerët.

Kompania duhet t'i rishikojë politikat e saj të burimeve njerëzore në lidhje me pushimet mjekësore dhe të marrë në konsideratë ndryshime, të cilat mund të jenë të përkohshme, për të siguruar që punëtorët potencialisht të sëmurë të mos kenë presion për të ardhur në punë, duke rrezikuar kështu që ta bartin virusin te pjesa tjetër e punëtorëve.

Mund të përdoret një pyetësor i shkurtër. Punëtorët duhet të paraqiten në punë vetëm nëse u përgjigjen me “jo” të gjitha pyetjeve. Më poshtë është një shembull:

- A keni qenë në dy javët e fundit në kontakt të afërt me një person që ka COVID-19?
- A keni qenë, në dy javët e fundit, në një vend/rajon me numër të lartë të rasteve të COVID-19?
- A keni temperaturë?
- A keni përdorur ilaçe të tilla si paracetamol ose aspirin për ta ulur temperaturën në 24 orët e fundit?
- A keni kollitje (qoftë edhe të butë)?
- A keni aktualisht vështirësi në frymëmarrje?

Siguroni, kur është e mundur, që punëtorët të ketë qasje adekuate në konsultime mjekësore, përfshirë me telefon, në rast se kanë simptoma.

Merrni në konsideratë, për të gjitha funksionet, si mund të përshtatet puna për ta bërë punën në shtëpi më praktike. Lehtësoni këtë sa më shumë që është e mundur.

## Higjiena e kollitjes<sup>(7, 16, 19)</sup>

Mënyra më e zakonshme për ta përhapur virusin është nga personat e infektuar që kolliten dhe teshtijnë. Punëtorët duhet të udhëzohen të ndjekin rregullat e kollitjes së sigurt, të përshkruara më poshtë për ta zvogëluar këtë rrezik:

- Mbuloni gojën dhe hundën me facoletë kur kollitet ose teshtini, dhe hidheni facoletën e përdorur në shportë mbeturinash.
- Kur nuk ka facoletë, kollituni ose teshtitni në mëngën e epërme ose bërryl, jo në duar.
- Pastroni duart pas kollitjes ose teshtitjes, mundësisht duke i larë mirë me ujë e sapun, duke ndjekur rekomandimet e organizatave shëndetësore. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion, përdorni xhel dezinfektues të duarve.

Kompania duhet të sigurojë që punëtorët të jenë të informuar mirë për rreziqet që lidhen me kollitjen dhe teshtitjen dhe masat për higjienën e kollitjes. Ajo duhet të sigurojë mundësi të mjaftueshme për larjen e duarve me ujë dhe sapun në të gjitha vendet e punës, dhe të sigurojë facoleta për një përdorim dhe shporta të mbeturinave. Ajo duhet edhe t'i inkurajojë njerëzit që të flasin nëse hasin në sjellje jo të rregullta.

## Distancimi social<sup>(16, 20)</sup>

Për ta parandaluar infeksionin nga personi në person, është e rëndësishme ta minimizoni kontaktin e drejtpërdrejtë sa më shumë që të jetë e mundur. Kur njerëzit punojnë ose takohen rregullisht, duhet të respektohet një distancë e sigurt prej 2 metrash (gjashtë këmbë) ndërmjet njerëzve.

Kompania duhet t'i identifikojë të gjitha vendet ku njerëzit normalisht punojnë më afër se 2 metra larg njëri-tjetrit. Rregulloni dizajnin e vendit të punës dhe proceset e punës për t'i minimizuar gjasat për këtë sa më shumë që të jetë e mundur. Disa shembuj që duhet të merren në konsideratë përfshijnë:

- Për vendet e palëvizshme të punës, të tilla si zyrat, fabrikat e veshjeve, linjat e paketimit, dhomat e kontrollit të cilësisë (KC), dhomat e mbledhjeve, etj., tregoni distancën e sigurtë, për shembull, vendosja e karrigeve ose shenjave në dysheme. Kur nuk mund të arrihet largësia prej 2 metrash, konsideroni zgjerimin e vendit të punës në zona më parë të lira, ose vendosjen e ndarjeve (me pleksiglas) ndërmjet vendeve të punës. Pastroni rregullisht ndarësit dhe hapësirën e punës (siç përshkruhet në pjesën tjetër më poshtë).
- Vendosni shenjat në dysheme, që e tregojnë distancën e sigurtë, ku njerëzit zakonisht presin, për shembull në korridorët e ashensorit, zonat e kontrollit të hyrjes së fabrikës, mensat, etj.
- Siguroni dhe përdorni video konferencat për t'i zëvendësuar takimet, të tilla si për dorëzim të ndërrimit, takimet e brendshme për siguri, takimet javore, etj.
- Informoni njerëzit për rreziqet e kontakteve të afërta, përfshirë me bashkëpunëtorët e drejtpërdrejtë, dhe promovoni sjellje alternative, të tilla si mbajtja e distancave të sigurta dhe përdorimi i alternativave në vend të shtrëngimit të duarve.
- Shtyni takimet sociale jo-thelbësore, veçanërisht për grupet më të mëdha se 10 persona ose siç kërkohet nga autoritetet përkatëse.
- Zvogëloni udhëtimeve kombëtare dhe ndërkombëtare (për shembull punën në terren dhe vizitat ndërmjet fabrikave në rajone të ndryshme) në vetëm minimumin absolut gjatë Pandemisë. Kur udhëtimi është thelbësor, respektoni kufizimet përkatëse të udhëtimit. Në qoftë se udhëtimi nuk është evakuim mjekësor, sigurohuni që personat që udhëtojnë të mos kenë simptoma të COVID-19 dhe të mos kenë qenë në kontakt me pacientët me COVID-19 brenda periudhës së rekomanduar nga autoritetet përkatëse (Shënim: Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) rekomandon 14-ditët e mëparshme).<sup>22</sup>
- Merrni në konsideratë vendosjen e ditëve të punës me rotacion ose shtimin e ndërrimeve shtesë për ta zvogëluar numrin e përgjithshëm të punonjësve në një ambient në një kohë të caktuar, duke u mundësuar atyre ta ruajnë distancën e rekomanduar nga njëri-tjetri, ndërsa duke mbajtur një javë të plotë pune.

## Dezinfektimi i duarve<sup>(7, 16, 20)</sup>

Larja e shpeshtë e duarve me ujë dhe sapun është kritike për parandalimin e infeksionit në mesin e punonjësve. OBSH rekomandon shpëlarjen dhe larjen e duarve me sapun për të paktën 20 sekonda, shpëlarje përsëri, dhe më pas përdorimi i letrës për fshirje, pasi ta ndalni rubinetën.

Kompania duhet ta promovojë larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me sapun dhe ujë dhe të sigurojë vende të mjaftueshme për punonjësit për t'i larë duart. Nëse sapuni dhe uji i rrjedhshëm nuk janë në dispozicion menjëherë, ofroni dezinfektues të duarve me bazë alkooli që përmbajnë të paktën 60% alkool. Sigurohuni që këto mundësi të jenë të mjaftueshme në numër dhe të jenë në dispozicion afër zonës së punës.

Përdorni vetëm peceta për një përdorim (letre) ose tharëse ajri. Mos përdorni peshqir të përbashkët për duar.

## Pastrimi dhe dezinfektimi<sup>(7)</sup>

Për ta parandaluar përhapjen e virusit, shpesh - dhe të paktën çdo ditë - pastroni sipërfaqet e prekura, të tilla si tavolinat, dorezat e dyerve, parmakët, ndërprerësit e dritave, pajisjet, sipërfaqet, dorezat, tavolinat, telefonat, tastierat, tualetet, rubinetat, lavamanët, etj. me radhë.

Përdorni mjetet e pastrimit që përdoren zakonisht si rutinë në këto sipërfaqe dhe ndiqni udhëzimet në etiketa. Për pajisjet që përdoren shumë, të tilla si karrocet ose shportat për blerje në dyqane, pastroni ato pas çdo përdorimi.

Kompania duhet të sigurojë që ka në dispozicion mjaft punonjës të pastrimit për t'i pastruar këto zona dhe duhet të kontrollojë për t'u siguruar që kjo kryhet.

Udhëzoni punonjësit që t'i pastrojnë sipërfaqet e tyre të punës dhe panelet e kontrollit në fund të çdo ndërrimi. Siguroni pajisje dhe udhëzime se si ta bëjnë këtë.

Siguroni peceta për një përdorim në mënyrë që sipërfaqet që përdoren shumë (për shembull, dorezat e dymve, tastierat, telekomandat dhe tavolinat) mund të fshihen nga punonjësit para dhe pas çdo përdorimi.

Siguroni pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (PMP) (shih paragrafin më poshtë) për personelin që kryen aktivitetet e pastrimit. Ndiqni udhëzimet e prodhuesve për përdorimin e produkteve të pastrimit dhe dezinfektimit.

### **Përgatitja e ushqimit<sup>(8)</sup>**

Punonjësit në kuzhinë duhet të ndihmojnë që të sigurohet që ushqimi i shërbyer për punëtorët të jetë i sigurt, ndërkohë që i zbatojnë edhe masat e sigurisë së ushqimit të kompanisë.

Punonjësit e kuzhinës duhet:

- Rreptësisht të mos paraqiten në punë nëse kanë simptoma të tilla si temperaturë, kollë, vështirësi në frymëmarrje, ose kanë qenë në kontakt të afërt me një pacient të konfirmuar me COVID-19.<sup>10</sup>
- Të trajnohen për praktikën e zakonshme të sigurisë së ushqimit, përfshirë ndërrimin e rrobave dhe larjen e duarve çdo herë para se të hyjnë në zonën e kuzhinës. Rrobat e kuzhinës nuk duhet të përdoren jashtë kuzhinës. Një dhomë ndërrimi me pajisjet për larjen e duarve dhe dollapë (të ndara sipas gjinive kur është e mundur) duhet të jetë në dispozicion. Rrobat e punës duhet të lahen në minimum 72°C në ditë.
- Të mos përfshihen në asnjë aktivitet të pastrimit ose dezinfektimit jashtë zonave të përgatitjes së ushqimit dhe ngrënies.
- Kërkohej që t'i lajnë duart rregullisht.
- Parandaloni kontaminimin e shkaktuar kur njerëzit e ndajnë të njëjtën lugë shërbimi. Kjo mund të arrihet duke shmangur paraqitjen e ushqimit në formë të bufesë (me vetë-shërbim). Në vend të kësaj, shërbeni ushqimin sa më shumë që të jetë e mundur nga punonjësit e kuzhinës ose shërbeni ushqimin në pjata individuale të shërbimit.
- Punëtorët duhet t'i lajnë duart me sapun përpara se të hyjnë në zonën e mensës.

### **Masat e kontrollit të cilësisë së ajrit<sup>(16)</sup>**

Rritja e ventilimit ose instalimi i filtrave të ajrit me efikasitet të lartë do të ndihmojë në largimin e viruseve në ambient dhe mund ta zvogëlojë rrezikun e infeksionit.

Merrni në konsiderim masa shtesë të kontrollit të cilësisë së ajrit për zonat ku nuk mund të evitohet afërsia personale, siç janë dhomat e kontrollit, ashensorët, dhomat e pritjes, etj.

### **Pajisjet mbrojtëse personale<sup>(21)</sup>**

Personat, siç janë punonjësit e kujdesit shëndetësor, të cilët mund të vijnë në kontakt me (potencialisht) persona të infektuar ose me materiale të infektuara duhet të përdorin doreza (për një përdorim) dhe maska mbrojtëse me vlerësim minimal prej N95 (standardi amerikan) ose P2 (standardi i BE-së) ose të ngjashme. Shihni edhe referencën në Shtojcën 1.

### **Akomodimet e punonjësve<sup>(7, 8, 16, 20)</sup>**

Akomodimi i punëtorëve është vendi ku zakonisht shumë njerëz qëndrojnë pranë njëri-tjetrit për një periudhë të gjatë, që paraqet rrezik të rritur të transmetimit.

Në raste të tilla, ndiqni të njëjtat parime të diskutuara më lart dhe gjithashtu merrni parasysh një ose më shumë nga masat vijuese shtesë:

- Mos i lejoni personat e infektuar të hyjnë në zonat e akomodimit të punëtorëve, dhe nëse është e zbatueshme ose e nevojshme, vendosni në karantinë këta persona sipas rregulloreve vendore dhe/ose rekomandimeve nga organizatat përkatëse ndërkombëtare.
- Promovoni, respektoni dhe zbatoni limitet e dendësisë në vendet e akomodimit të punëtorëve.
- Në rast se punonjësi i ri vjen nga vendet ose zonat me rrezik të lartë të COVID-19, sigurohuni që këta persona të karantinohen siç duhet sipas rregulloreve vendore dhe/ose rekomandimeve nga organizatat përkatëse ndërkombëtare.
- Kur është e mundur, koordinatori i banimit ose personi (personat) përgjegjës për menaxhimin e akomodimeve duhet të koordinojnë që banorëve t'u matet temperatura çdo ditë. Shënim: Përdorni termometër që e pengon kontaminimin, dhe që e mbron personin që e mat temperaturën e banorëve nga infeksioni i mundshëm (shih më lart).
- Kur në akomodim ka njerëz në rrezik të lartë për zhvillim të komplikimeve fatale nga COVID-19, merrni në konsiderim që t'u siguroni atyre strehim të veçantë. Në këtë kontekst personat e moshës 65 vjeç ose më të vjetër, ose ata me shtypje të lartë të gjakut, sëmundje të zemrës, sëmundje të mushkërive, kancer ose diabet, konsiderohen me rrezik të lartë.<sup>22</sup>
- Sigurohuni që të gjithë punëtorët të kenë qasje te profesionistët mjekësorë. Hiqni të gjitha pengesat gjuhësore.
- Sapuni për larje të duarve duhet të vihet në dispozicion të punëtorëve në të gjitha tualetet. Të gjithë duhet të ndjekin çdo ditë një rutinë të rreptë të pastrimit dhe rregullimit të shtëpisë.
- Dorezat e dyerve, rubinetat, TV/pajisjet e mediave, pajisjet e kuzhinës, kontrollet, butonat dhe objektet e tjera në zonat e përbashkëta që preken rregullisht duhet të pastrohen disa herë në ditë. Shpeshtësinë duhet ta përcaktojë secili objekt.
- Sipërfaqet e përbashkëta, përfshirë ato në automjetet që i transportojnë punëtorët nga banesat e tyre në vendin e punës, sportelet, dyshemetë dhe muret, duhet të trajtohen si të kontaminuara potencialisht dhe të pastrohen rregullisht siç përshkruhet më lart.
- Shtresat e shtratit duhet të lahen në 72°C të paktën një herë në javë.
- Pastroni/ndërroni filtrat e AC të paktën çdo muaj.
- Minimizoni numrin e njerëzve në një dhomë dhe rritni, sa është e mundur, distancën ndërmjet shtretërve deri më shumë se 2 metra.
- Rritni në maksimum ventilimin natyral ose të detyruar brenda kufijve të rehatisë, sigurisë dhe privatësisë. Merrni në konsiderim ndryshimet në objekt për ta lejuar ventilimin gjatë orarit të punës.
- Lejoni ose përgatisni akomodime shtesë për punëtorët që janë bllokuar për shkak të kufizimeve të udhëtimit dhe të cilët nuk mund të riatdhesohen.

### **Kujdesi shëndetësor në zonat e largëta<sup>(23)</sup>**

Kujdesi primar shëndetësor gjithmonë duhet të ofrohet nga profesionistë të kualifikuar mjekësorë në përputhje me rregulloret lokale. Për personat që jetojnë në banesë të kompanisë me simptoma të buta që nuk kërkojnë shtrimin në spital, duhet të sigurohet kujdes i vazhdueshëm gjatë sëmundjes.

Pacientëve të tillë duhet t'u ofrohet kujdes i mirë në një zonë të izoluar nën mbikëqyrjen mjekësore. Ndiqni udhëzimet për kujdesin në shtëpi për pacientët me COVID-19 të dhëna nga OBSH ose autoriteti tjetër përkatës. Udhëzimet e OBSH-së mund të gjenden në <https://apps.who.int/iris/handle/10665/331133>.

Kur personat deklarohen të shëndetshëm<sup>9</sup> dhe kthehen në vendin e punës, sigurohuni që të jepen udhëzime të mjaftueshme për ta parandaluar diskriminimin ose ndonjë sjellje tjetër të padëshirueshme nga ana sociale.

---

---

## SHTOJCA 1. BURIMET DHE LINQE TË DOBISHME:

- 1: Shërbimi këshillues, i pajtimit dhe arbitrimit ACAS UK (2020) Koronavirus COVID-19: këshilla për punëdhënësit dhe punëmarrësit, <https://www.acas.org.uk/coronavirus>
- 2: Unioni kanadez i punonjësve publikë (2020) Udhëzimet e përgjithshme profesionale për COVID-19, <https://cupe.ca/general-occupational-guidelines-covid-19>
- 3: Korporata zhvillimore e komonueletit -CDC- Grupi (2020) COVID-19 Udhëzimet për punëdhënësit, <https://assets.cdcgroup.com/wp-content/uploads/2020/03/23093424/COVID-19-CDC-ESG-Guidance.pdf>
- 4: Punësimi në Zelandë të Re (2020) Përgjigja ndaj koronavirusit në vendin e punës (COVID-19), <https://www.employment.govt.nz/about/news-and-updates/workplace-response-coronavirus-covid-19/#guidance>
- 5: BE CDC (mars 2020) Shpërthimi i sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) dhe siguria dhe shëndeti në punë, <https://osha.europa.eu/en/highlights/coronavirus-disease-covid-19-outbreak-and-workplace-safety-and-health>
- 6: BE CDC COVID-19 faqja, <https://www.ecdc.europa.eu/en/novel-coronavirus-china>
- 7: BE OSHA COVID udhëzimet për vendin e punës, [https://oshwiki.eu/wiki/COVID-19:\\_guidance\\_for\\_the\\_workplace#See](https://oshwiki.eu/wiki/COVID-19:_guidance_for_the_workplace#See)
- 8: IPIECA (2016) Menaxhimi i përhapjes së sëmundjeve infektive në industrinë e naftës dhe gazit. Ky dokument përmban posterë që tregojnë teknikat efektive të larjes me ujë dhe sapun dhe të dezinfektimit dhe sjelljet e mira gjatë kollitjes. <http://www.ipieca.org/resources/good-practice/infectious-disease-outbreak-management-a-programme-manual-for-the-oil-and-gas-industry/>
- 9: Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (2020) udhëzimet e qëndrimit në shtëpi për COVID-19, <https://www.gov.uk/government/publications/covid-19-stay-at-home-guidance/stay-at-home-guidance-for-households-with-possible-coronavirus-covid-19-infection>
- 10: Kombet e Bashkuara – COVID-19 faqja: <https://www.un.org/coronavirus>
- 11: SHBA CDC – COVID-19 faqja, [https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/index.html?CDC\\_AA\\_refVal=https%3A%2F%2Fwww.cdc.gov%2Fcoronavirus%2Fnovel-coronavirus-2019.html](https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/index.html?CDC_AA_refVal=https%3A%2F%2Fwww.cdc.gov%2Fcoronavirus%2Fnovel-coronavirus-2019.html)
- 12: SHBA CDC (2020) Udhëzimet e përkohshme për bizneset dhe punëdhënësit për planifikimin dhe përgjigjen ndaj sëmundjes së koronavirusit 2019 (COVID-19), <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/community/guidance-business-response.html>
- 13: SHBA CDC (2003) Udhëzimet për kontrollin e infeksionit në mjedis në institucionet e kujdesit shëndetësor, <https://www.cdc.gov/mmwr/preview/mmwrhtml/rr5210a1.htm>
- 14: Departamenti i punës i SHBA-ve (2020) Burimet rreth koronavirusit, <https://www.dol.gov/coronavirus>
- 15: Instituti kombëtar i shëndetit i SHBA-ve (2020) Koronavirusi (COVID-19). <https://www.nih.gov/health-information/coronavirus> (janë udhëzimet e përkohshme për bizneset dhe punëdhënësit për planifikimin dhe përgjigjen ndaj sëmundjes së koronavirusit 2019 (COVID-19))
- 16: ASHSP e SHBA (2020) Përgatitja e vendit të punës për COVID-19, <https://www.osha.gov/Publications/OSHA3990.pdf>
- 17: ASHSP e SHBA (2020) Faqja e sëmundjeve infektive, [https://www.osha.gov/SLTC/healthcarefacilities/infectious\\_diseases.html#cdc\\_guidelines](https://www.osha.gov/SLTC/healthcarefacilities/infectious_diseases.html#cdc_guidelines)
- 18: ASHSP e SHBA (2020) Udhëzimet e pandemisë së gripit, <https://www.osha.gov/SLTC/pandemicinfluenza/index.html>

- 19: Administrata e bizneseve të vogla e SHBA-ve (2020) Koronavirusi (COVID-19): Udhëzimet dhe resurset kreditore për bizneset e vogla. <https://www.sba.gov/page/coronavirus-covid-19-small-business-guidance-loan-resources>
- 20: OBSH përgatitja e vendit tuaj të punës për COVID-19, <https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/getting-workplace-ready-for-covid-19.pdf>
- 21: OBSH (2020) këshilla për publikun mbi COVID-19: Kur dhe si të përdoren maskat, <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public/when-and-how-to-use-masks>
- 22: OBSH COVID-19 faqja: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019>
- 23: OBSH (2020) Kujdesi shtëpiak për pacientët e dyshuar për infeksion me koronavirusin e ri (COVID-19) që paraqesin simptoma të lehta, dhe menaxhimi i kontakteve të tyre: udhëzimet e përkohshme, 04 shkurt 2020, <https://apps.who.int/iris/handle/10665/331133>
- 24: Siguria dhe shëndetin në vendin e punës Siguria nga rryma elektrike Rregullatori i kompensimit të punonjësve në zyrë – Qeveria e Kuinsland, Australi (2020) Menaxhimi i rrezikut të koronavirusit (COVID-19) në vendin e punës, <https://www.worksafe.qld.gov.au/news/2020/coronavirus-covid-19-workplace-risk-management>

---

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2020. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

*Deklarata e mohimit të përgjegjësive: Ky dokument përmban këshilla që synojnë për t'u ndihmuar klientëve të KFN-së në masat si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19. Klientët duhet t'i referohen edhe informacionit dhe rekomandimeve që lidhen me COVID19 nga Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) dhe organizata të tjera ndërkombëtare të specializuara të shëndetit dhe kontrollit të sëmundjeve, si dhe informacioneve nga autoritetet shëndetësore qeveritare lokale, regjionale dhe kombëtare, duke cekur se rekomandimet e tilla mund të ndryshojnë. Informacioni relevant mund të jetë në dispozicion edhe nga organizatat ndërkombëtare brenda sektorëve të biznesit të klientëve. Ky dokument nuk ka për qëllim të jetë shterues, dhe ofron informata të përgjithshme dhe jo udhëzime specifike për sektorët. Klientët në sektorët me rrezik të lartë duhet t'i referohen procedurave dhe standardeve specifike për ata sektorë.*


*Ju lutemi vini re se përderisa janë bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që informacioni i përfshirë në këtë dokument është i saktë, i plotë dhe i fundit, rrethanat mund të ndryshojnë me shpejtësi dhe ky dokument mund të mos i pasqyrojë zhvillimet aktuale. KFN nuk garanton saktësinë, plotësinë ose aktualitetin e informacionit në këtë dokument. KFN nuk merr përgjegjësi as detyrim për gabimet, lëshimet ose mospërputhjet në informacionin në këtë dokument, dhe nuk merr përgjegjësi as detyrim në lidhje me përdorimin ose mbështetjen në çdo informacion, metodë, procese, përfundime ose gjykime në këtë dokument. Informacioni i përfshirë në këtë dokument nuk ka për qëllim të përbëjë këshilla ligjore, afariste ose mjekësore dhe nuk duhet mbështetur në të ose të trajtohet si zëvendësim i këshillave specifike nga këshilltarët profesionistë të klientëve.*

*Shpërndarja: KFN inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe lexuesit të mund t'i rikrijojnë dhe shpërndajnë këto materiale për qëllime edukative dhe jo komerciale, me kusht që të jepet një atribut i duhur dhe të përfshihet mohimi i përgjegjësive.*

*Faleminderit bashkëpunëtorëve të Ergon-it për kontributin e tyre në këtë produkt.*

*Mësoni më shumë për KFN-në dhe punën që në e bëjmë për t'i përmirësuar praktikën e MSQ-së: [ifc.org/sustainability](https://www.ifc.org/sustainability)  
2121 Pennsylvania Avenue, N.W.  
Washington, D.C. 20433  
Internet: [www.ifc.org](http://www.ifc.org)*

## Në partneritet me:



Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

